

Procedurat e pranimit dhe transferimit

Për t'u pranuar në një program studimi të ciklit të dytë, kandidati duhet të ketë një diplomë të ciklit të parë të studimeve në fushën përkatëse ose në fusha të tjera të përafërta.

Kandidati fiton statusin e studentit dhe ka të drejtë të ndjekë studimet në vitin akademik përkatës, nëse rregjistrohet pranë sekretarisë mësimore të universitetit brenda afateve kohore të përcaktuara dhe të shpallura paraprakisht.

Për t'u regjistruar studenti duhet të paraqesë pranë sekretarisë mësimore dokumentacionin si më poshtë:

1. Kopje të noterizuar të diplomës së studimeve bachelor të kryera, shoqëruar me suplementin e diplomës.
2. Kopje të noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me çertifikatën e notave.
3. Formularin e aplikimit.
4. 2 foto
5. Fotokopje të Kartës së Identitetit
6. Certifikata e mbrojtjes së gjuhëve të huaja.

Për të nisur studimet master, studenti duhet të pranojë kushtet e paracaktuara në Statutin, Rregulloren dhe Kontratën e Studimit të SHPAL "Universiteti Metropolitan Tirana".

Procedurat e transferimit në ciklin e dytë të studimeve në SHPAL "Universiteti Metropolitan Tirana".

Për tu regjistruar, kandidati paraqet pranë sekretarisë mësimore të fakultetit përkatës dokumentacionin e nevojshëm si më poshtë:

1. Plani i plotë i programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse origjinal
2. Vërtetim të listes së notave dhe krediteve të fituara për cdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur;
3. Kopje të noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave, ose të një deftese/diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të në Shqipëri dhe të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS).

Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme, duhet të paraqesë, dublikate të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtorja e shkollës së mesme dhe të

vërtetuar në Drejtorinë Arsimore Rajonale/Zyra Arsimore përkatëse, ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;

4. Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);

5. Dy fotografi personale.

6. Faturën e pagesës së tarifës së regjistrimit.

Shtetasit e huaj duhet të paraqesin lejen e qëndrimit në Shqipëri. Të pranojë kushtet e përcaktuara në Statutin, Rregulloren dhe Kontratën e Studimit të SHPAL “Universiteti Metropolitan Tirana”.